



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 5398/prot
3

Tiranë, më 31/04 2025

Lënda: *Indeksi i kuotës ushqimore për vitin 2025*

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
DREJTORIA RAJONALE BERAT, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER,
GJIROKASTËR, KORCË, KUKËS, LEZHË, SHKODËR, TIRANË, VLORË,
SHTËPIA E FOSHNJES TIRANË, KORCË, SHKODËR, DURRËS, VLORË
SHTËPIA E TË MOSHUARVE TIRANË, GJIROKASTËR, KAVAJË, FIER,
SHKODËR, QENDRA POLIVALENTE POLICAN, SARANDË, DITORE KAMËZ
QENDRA KOMUNITARE E MOSHËS SË TRETË PALASË,
SHTËPIA E FËMIJËVE 16-18 VJEC SHKODËR, SHKOLLORË SHKODËR,
SHKOLLORË TIRANË, SARANDË,
QENDRA E ZHVILLIMIT TIRANË, KORCË, SHKODËR, BERAT, VLORË, DITOR
LEZHE, DITORE KORCË, REZIDENCIAL DURRËS,
QKTE TIRANË, QKTV DHUNËS,
QENDRA PRITËSE E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TIRANË

Për dijeni:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

Në zbatim të Udhëzimit të MSHMS nr 662 prot., datë 06.12.2022 për "Një ndryshim në udhëzimin nr. 689 dt 02.10.2018 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore", si dhe urdhërit nr. 258 dt 30.06.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e nivelit të kuotave ushqimore për institucionet e Shërbimit Social Shtetëror", bashkangjitur gjeni urdhërin dhe relacionin për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore.

Përlllogaritja e kuotës për çdo grupomoshë është bërë në bazë të çmimeve të fundit të *INSTAT-Qershor 2025*, si dhe çmimet e tregut. Tabelat përkatëse ndodhen pranë Shërbimit Social Shtetëror.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reme Xhelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 5398/_{1/2} prot

Tiranë, më 31/07 2025

URDHËR

Nr. 293 prot, datë 31/07/2025

**PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME NË
INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESJES
SHOQËRORE**

Në mbështetje të Ligjit nr 121/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 23, VKM nr. 518 dt 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për pëfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, urdhërit nr. 258 dt 30.06.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e nivelit të kuotave ushqimore”, si edhe Udhëzimit të MSHMS nr 662 prot., datë 06.12.2022 për “Një ndryshim në udhëzimin nr. 689 dt 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”

URDHËROJ:

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:

- Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve – 440 lekë
- Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 0-3 vjeç – 400 lekë
- Për fëmijët e grup moshës 4-5 vjeç – 400 lekë
- Për fëmijët e grup moshës 6-12 vjeç – 500 lekë
- Për fëmijët e grup moshës 13-15 vjeç – 610 lekë
- Për fëmijët e grup moshës 16-18 vjeç – 600 lekë
- Për përfituesit mbi moshën 18 vjeç – 620 lekë
- Për përfituesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7-11 vjeç – 510 lekë
- Për përfituesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 11 vjeç – 620 lekë

2. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:

- Në qendrat ditore polivalente- 310 lekë
- Në qendrat ditore të zhvillimit- 350 lekë
- Në shtëpitë ditore të fëmijës – 350 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

3. Niveli i kuotës financiare të përballimit për shpenzimet ditore ushqimore për guzhinjerët dhe ndihmës guzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëhere.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reme Xholi

